



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.281/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër Ganimete Musliut kandidate për deputeteKoalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ashtu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 300 (treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën pretendon se Ganimete Musliut kandidate për deputete nga koalicioni PDK-AAK-NISMA gjat heshtjes zgjedhore ka sponsorizuar artikuj në rrjetin social facebook te cilat janë shfaqur tek qytetaret gjat ditës së zgjedhjeve. Parashtruesi i ankesës thekson se sipas rregullave të facebookut sponsorizimi kryhet me vetëdije të plotë duke përcaktuar data dhe ora e sakt se kur duhet të shfaqet postimi. Parashtruesi i ankesës thekson se kandidati në fjale ka sponsorizuar materiale duke shkelur nenin 36.1 të LZP-së Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e ligjit per zgjedhjet e përgjithshme.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës shihet se si kandidatja për deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA , Ganimete Musliut gjatë heshtjes zgjedhore dhe gjatë ditës së votimit në rrjetin e saj social facebook ka bërë fushate zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet nr 51, ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Koalicioni PDK-AAK-NISMA është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.281/2017 më datën 13.06.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.